



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2020:084263  
Datë: 14.03.2024  
Numri i dokumentit: 05450365

C.nr.1171/20

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në kontestin e paditësit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë e Kosovës, kundër të paditurit G.S.B. me adresë në fshatin ...-Komuna Ferizaj, me numër personal .., për pasurim të pa bazë, vlera e kontestit 115,00€, me datën 14.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Padia e paditësit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë e Kosovës, kundër të paditurit G.S.B. me adresë në fshatin ...-Komuna Ferizaj, për pasurim të pa bazë, vlera e kontestit 115,00€, konsiderohet e tërhequr.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë me datë 09.07.2020, kundër të paditurit, për pasurim të pa bazë, vlera e kontestit 115,00€.

Me datën 21.02.2024, ora 13:20 gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit përgatitor, në të cilën nuk ka prezantuar paditësi (përfaqësuesi ligjor i tij-Avokatura Shtetërore) edhe pse në shkresat e lëndës ka pasur prova se i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, sipas fletëkthesës së datës 05.01.2024 ndërsa mungesën e tij nuk e ka arsyetuar, ndërsa nuk ka prezentuar as i padituri, i cili sipas fletëkthesës së datës 05.01.2024 rezulton se ftesën për seancë e kishte pranuar në mënyrë të rregullt ndërsa mungesën nuk e kishte arsyetuar.

Pasi që paditësi (përfaqësuesi ligjor i tij) mungoi në seancë ndërsa mungesën e tij nuk e ka arsyetuar si dhe nuk ka propozuar shtyerje të seancës, në bazë të nenit 409.1 të LPK, gjykata vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Lidhur me pikën II. të dispozitivit të këtij aktvendimi u vendosë konform nenit 450 të LPK, në të cilin parashihet se: “Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.”

Nga të gjitha të lartëcekurat, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi e konform nenit 142 të LPK.

#### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Datë 14.03.2024

Gjyqtari,  
Armend Ahmeti

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit, e nëpërmjet të kësaj gjykate.